



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:066647

Datë: 11.06.2024

Numri i dokumentit: 05809010

KPPP.nr.1413/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përmbarimore të kreditorit Agjencia Kosovare e Privatizimit, Zyra Rajonale në Prishtinë, duke vepruar në emër dhe për llogari të NSh “Rilindja Shtypshkronja”, me seli në rr. “Dritan Hoxha”, nr. 55, në Prishtinë, kundër debitorit “FSF” SH.P.K., me numër të biznesit: 70964562, me seli në rr. “Pashko Vasa” Nr. 2-1, në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr.51/22 të datës 18.03.2022, të Përmbaruesit Privat Irfan Kërçagu me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 11.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit “FSF” SH.P.K., i paraqitur kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr.51/22 të datës 18.03.2022, të Përmbaruesit Privat Irfan Kërçagu.
- II. MBETET në fuqi Urdhri Përmbarimor P.nr.51/22 të datës 18.03.2022, të Përmbaruesit Privat Irfan Kërçagu.

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Agjencia Kosovare e Privatizimit, Zyra Rajonale në Prishtinë, duke vepruar në emër dhe për llogari të NSh “Rilindja Shtypshkronja”, ka lëshuar urdhrin përmbarimor P.nr.51/22 të datës 18.03.2022, me të cilin ka lejuar përmbarimin, në bazë të dokumentit të besueshëm: Faturës Nr. 1 të datës 04.03.2019; Faturës Nr. 2 të datës 04.04.2019 dhe Faturës Nr. 3 të datës 06.05.2019; me të cilën është detyruar

debitori që në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturave të lartcekura, që në afat prej 7 ditësh nga data e pranimit të urdhrit t'ia paguaj kreditorit shumën e përgjithshme prej 4,196.01 €, me kamatë prej 8% në vit, e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore, nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm, në të kundërtën këto detyrime të realizohen përmes bllokimit të llogarive bankare të debitorit, ndërsa nëse nga llogaritë bankare të debitorit nuk mund të realizohet kërkesa e kreditorit, atëherë të urdhërohet regjistrimi, marrja dhe shitja e sendeve të luajshme dhe të paluajshme të debitorit deri në realizimin e kërkesës së plotë të kreditorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor, ku ndër të tjerash ka deklaruar se faturat nuk janë të nënshkruara nga ana e përfaqësuesit të autorizuar të debitorit dhe nuk janë të vulosura nga ana e debitorit, mbi këtë bazë nuk ekzistojnë dëshmi të mjaftueshme se debitori ka pranuar një kopje fizike të këtyre faturave. Më tutje ka theksuar se në rast se faturat në fjalë do të pranoheshin nga personat e autorizuar, të njëjtit në momentin e pranimit të tyre do të kishin mundësinë e kundërshtimit të faturës apo paralajmërimit të kreditorit në lidhje me vërejtjet që i kanë lidhur me faturën e lëshuar. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet në tërësi prapësimi i debitorit, të anulohet urdhri përmbartimor si dhe të gjitha veprimet e kryera në këtë procedurë dhe të detyrohet kreditorit t'i kompensoj shpenzimet procedurale debitorit.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka deklaruar se prapësimi i debitorit nuk mbështetet në prova të duhura konform dispozitave të parapara ligjore. Ka theksuar se në propozimin për përmbartim janë të bashkëngjitura faturat e lartcekura të cilat janë të nënshkruara nga debitori. Gjykatës i ka propozuar që të hedhet poshtë prapësimi i debitorit.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pa bazuar, duke vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbartim, i plotësojnë kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmbajnë të gjitha

elementet e kërkuara dhe janë të përshtatshme për përmbardim, bazuar në dispozitat e nenit 29 par.3 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se “Përmbardimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se “Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbardim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”. Me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “Kur propozimi për përmbardim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbardimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbarduesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm: Faturën Nr. 1 të datës 04.03.2019; Faturën Nr. 2 të datës 04.04.2019 dhe Faturën Nr. 3 të datës 06.05.2019; të cilat fatura i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në këto fatura janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara mallrat të cilat kanë qenë objekt i këtyre faturave, është përcaktuar shuma e cila përben detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, koha e përmbushjes së këtij detyrimi si dhe të njëjtat janë bërë të arritshme për pagesë.

Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat e lartcekura i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP, për zbatimin e përmbardimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që të njëjtat janë dorëzuar në origjinal, si dhe mbajnë nënshkrimin e pranimit nga debitori.

Andaj bazuar në të lartcekurat, gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbardimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1413/23, datë 11.06.2024

Gjyqtari

Hasan Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.